



KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 622 Prot.

Tiranë, më 10.05 2017

**VENDIM Nr. 61, datë 26.04.2017**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.7, datë 26.04.2017, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Shkodra"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. As. Saimir Shpuza dhe Prof. Piotr Dyczek (Univesiteti Varshavës), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Shkodra"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), drejtues Prof. As. Saimir Shpuza dhe Prof. Piotr Dyczek (Univesiteti Varshavës), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
  - Gërmime në qytetin e poshtëm, pranë rrugës hyrëse të qytetit të Shkodrës pasi kalon Urën e Bunës.
  - Në qytetin e sipërm do të vazhgojë gërmimi i nisur në vitin 2016, në zonën prapa Kishës së Shën Stefanit.
  - Edhe këtë vit projekti shqiptaro -polak do të vazhdojë ndërtimin e hartës GIS për territorin e Shkodrës dhe do të fokusohet më shumë në sitet e fortifikuara.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë periudha kohore e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2017.
3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARGO FURXHI**  
**MINISTRE**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**